



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok.201900553/8

Tiranë ___/___/2020

Lënda: *Rekomandim për fillimin e hetimit të procedimit penal ndaj punonjësve të policisë së Komisarariatit nr.4 Tiranë, për veprën penale "Kryerja e veprimeve arbitrare", parashikuar nga nenet 250 e 25 të Kodit Penal, për prangosjen e shtetasit A.G në Spitalin Universitar të Traumës*

PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR
TIRANË

Për dijeni: DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË POLICISË SË SHTETIT
TIRANË

SHËRBIMIT PËR ÇËSHTJET E BRENDSHME DHE ANKESAT
TIRANË

KOMISARIATIT TË POLICISË NR.4
TIRANË

Të nderuar,

Në institucionin e Avokatit të Popullit është regjistruar me iniciativë rasti i bërë publik në media për prangosjen e shtetasit A.G në spitalin Universitar të Traumës, gjatë kohës që po merrte trajtim, pas protestës së datës 13 prill 2019 të organizuar nga subjekti Partia Demokratike, në Bulevardin "Dëshmorët e Kombit" dhe tek sheshi para Parlamentit.

Avokati i Popullit ka monitoruar protestat e organizuara, duke shprehur shqetësim për qasjen e punonjësve të Policisë së Shtetit ndaj protestuesve, edhe pse ka kërkuar në mënyrë të përsëritur që organet e policisë të garantojnë me të gjitha mënyrat që qytetarët

të shprehin pakënaqësitë e tyre në mënyrë paqësore, të pashqetësuar e të pavënë nën presion të çdo lloji.

Për këtë rast, është vendosur të kryhet një hetim i pavarur administrativ, i cili ka konsistuar në marrjen e deklarimeve të shtetasit A.G, marrjen e deklarimeve të punonjësve të policisë të Komisarariatit nr.4 të pyetur nga ana jonë, marrjen e dokumentacionit në komisariate, IEVP “Jordan Misja”, si dhe shkresave “kërkesë për informacion” drejtuar Komisarariatit nr.4 dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat.

Fillimisht përfaqësuesit e Institucionit të Avokatit të Popullit kanë marrë kontakt me shtetasin A.G gjatë kohës kur mbahej i arrestuar në ambientet e Komisarariatit nr.1 Tiranë. Nga ndihmëskomisionerët e institucionit të Avokatit të Popullit iu bënë edhe disa foto shtetasit.

Në deklaratimet e tij, shtetasi A.G shpjegoi se ndaj tij ishte ushtruar dhunë gjatë kapjes nga punonjësit e policisë. Konkretisht ai referoi se rreth orës 10³⁰ ose 11⁰⁰ të datës 13.04.2019 ka qenë te rruga “Xhorxh Bush”. Mbante një kapuç-shall të lidhur në kokë. Kanë ardhur disa punonjës policie civile të cilët e kanë rrahur barbarisht, pa e paralajmëruar se ishin punonjës policie. Më pas e kanë dërguar në komisariatin nr.4, ku e kanë mbajtur 2 orë dhe nuk e nisnin për në spital. E kanë ofenduar gjatë kohës së marrjes në pyetje.

Më vonë e kanë dërguar në spital dhe e kanë mbajtur të prangosur në spitalin ushtarak, gjatë kohës kur po merrte trajtim mjekësor, edhe pse në spital kishte forca të shumta policie. Në momentin e prangosjes kanë qenë të pranishëm 3 policë në dhomën e spitalit.

Në ambientet e spitalit e kanë marrë në pyetje 2 policë të komisarariatit nr.4, pas marrjes së serumit. Po ashtu, ai ka deklaruar se nuk ka pasur prezent avokat kur është marrë në pyetje si dhe nuk ka kontaktuar me asnjë avokat.

Nga stafi mjekësor i janë bërë grafi në brinjë, si dhe skaner. Doktorit i ka thënë se kishte shembje. Gjatë qëndrimit në spital deri në orën 9⁰⁰ të mëngjesit, kishte marrë një serum dhe nuk ishte trajtuar me ushqim. Në mëngjes, është lejuar të takohej me të atin, i cili i kishte sjellë një kafe dhe ujë.

Atë mëngjes, pasi ka dalë nga spitali është dërguar fillimisht në komisariatin nr.4, ku ndenji rreth 5 minuta. Më pas është shoqëruar në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë për të marrë shenjat e gishtave dhe pas një ore është vendosur në Komisariatin nr.1.

Gjatë këqyrjes së procesverbalit për arrestimin në flagrancë, të cilin e dispononte shtetasi i arrestuar, pasqyrohet se shtetasi ishte mbajtur nën vëzhgim nga punonjësit e policisë së Komisarariatit nr.4, ishte ndaluar tek ish kafe Europa dhe se kishte kundërshtuar punonjësit e policisë. Arrestimi në flagrancë i shtetasit është bërë, pasi dyshohet se ka kryer veprat penale “Kundërshtim i punonjësit të policisë së rendit publik” dhe “Prishja e qetësisë publike”, parashikuar nga nenet 236/2 dhe 274 të Kodit Penal. Në fund të procesverbalit konstatohet të jetë i firmosur nga av. E.C, ndërkohë kur shtetasi i arrestuar pretendon se nuk kishte avokat present, gjatë kohës kur është marrë në pyetje në spital.

Në kuadër të hetimit administrativ, nga veprimet hetimore të kryera nga ana jonë, konstatohet si më poshtë vijon:

Në shkresën nr.3745/1, datë 07.06.2019 të Komisarariatit të Policisë nr.4 Tiranë konstatohet: “Më datë 13.04.2019 rreth orës 21¹⁰ nga ana e sallës Operative jemi njoftuar se “shërbimet e njësisë operacionale, kërkojnë një shërbim tek Prokuroria e Përgjithshme, pasi kanë një shtetas për të shoqëruar”. Menjëherë kemi nisur shërbimin me kod 53/29, me punonjës policie Inspektor Ermal Kurtaj dhe Shkurt Toma të cilët pasi kanë marrë takim me ta, u kanë thënë për të shoqëruar dhe e kanë shoqëruar në Komisariatin e Policisë nr.4, shtetasin A.G, pasi sipas tyre ky shtetas ka kryer veprime të dhunshme në protestë.

Gjatë kohës që ishte në dhomat e shoqërimit, ky shtetas ishte jobashkëpunues me personelin e shërbimit, duke komunikuar me tone të larta e shpeshherë edhe ofenduese me punonjësit e policisë. Rreth orës 23⁴⁵ ky shtetas ka pretenduar se kishte probleme shëndetësore dhe menjëherë është dërguar për ndihmë mjekësore në Spitalin e Traumës (Ushtarak) me shërbimin me kod 53/30, me punonjësit e policisë Inspektor Emiljano Vasha dhe Klevis Mydini së bashku me ndihmëspecialistët e Hetimit të Krimeve Inspektor Aldo Pata dhe Klajdi Xhepexhiu. Theksoj se ky shtetas gjatë të gjithë kohës së qëndrimit në ambientet e komisarariatit dhe spitalit ka qenë shumë i dhunshëm dhe agresiv. Menjëherë me të mbërritur te spitali, pasi morëm takim me mjekët, shtetasin A.G e kaluam në dhomën nr.5, ku ishin 5 shtretër të tjerë, pacientë dhe familjarë, duke qenë në këto kushte komunikua edhe me mjekun në rast se prangosja kishte probleme për shëndetin e të shoqëruarit. Mjeku na konfirmoi se nuk ka probleme, në këto kushte bëme prangosjen e shtetasit.”

Nga ana jonë gjithashtu, janë marrë deklaratimet e punonjësve të policisë së Komisarariatit nr.4 që kanë kryer kapjen e shtetasit, Viktor Gjika, Sabah Fetahu, Ylli Hasani, Ilir Fejza, Ferald Leka.

Në shpjegimet e tyre, në mënyrë përmbledhëse ata referojnë se: Në datë 13 prill kanë qenë të planizuar te Kryeministria fakt i cili vërtetohet edhe nga plani i masave për evidentimin e personave të dhunshëm në vendet ku u zhvillua protesta. Gjatë monitorimit, ata kishin konstatuar një person i cili mbante një maskë të zezë dhe një zinxhir metalik në dorë, që sipas tyre e vërviste në ajër për të provokuar punonjësit e policisë. Kur shtetasi lëvizti nga Kuvendi, drejt Kafe Europës me maskë dhe zinxhir në dorë, e kanë ndaluar, janë prezantuar si punonjës policie dhe i kanë kërkuar të identifikohet dhe të hiqte maskën. Sipas deklaratave të punonjësve të policisë, ai nuk ka pranuar. Në këtë moment, kanë bërë bllokimin e tij dhe kanë njoftuar sallën për të bërë veprimet e mëtejshme. Këto veprime janë kryer konform ligjit dhe nuk është ushtruar dhunë mbi shtetasin në fjalë.

Në komisariatin nr.1 dhe më pas në IEVP “Jordan Misja” janë tërhequr kartelat mjekësore. Sipas kartelës klinike nr.1987, datë 16.04.2019 të shërbimit parësor në burgje rezultoi se shtetasi ankohet për dhembje në shpinë, në kokë, dhe dobësi trupore. Sqaron se ka qenë pjesëmarrës në protestë dhe gjatë konfliktit është goditur në kokë dhe në trup. Gjendja e përgjithshme e mirë. Në sipërfaqen e lëkurës në pjesën trupore dhe të krahut të majtë, konstatohet një gërvishtje e lehtë.

Pas ekzaminimeve në Spitalin e Traumës rezultoi pa patologji. Klinikisht shëndoshë. Ka dalë nga spitali në orën 9⁰⁰ në datë 14.04.2019, me recetë për kontuzionet e indeve të buta. Në komisariat është trajtuar me ibuprofen 400 mg.

Në shpjegimet e marra nga mjekja e IEVP “Jordan Misja”, rezulton se: *“Në datë 16.04.2019 si anëtare e komisionit të pritjes, kam qenë e pranishme kur është paraqitur shtetasi A.G. Pacienti në hyrje referoi se ndaj tij është ushtruar dhunë nga punonjësit e policisë së shtetit si pjesëmarrës në një protestë, është goditur në kokë dhe në gjoks.*

Në ekzaminimin objektiv u vunë re:

Në sipërfaqen e parakrahut të majtë një hematomë e lehtë në rezorbim;

Në pjesën e fytyrës disa gërvishtje të lehta.

Pacienti vjen me një epikrizë nga Spitali i Traumës ku përshkruhen ekzaminimet që i janë kryer, konstatimet dhe rekomandimet përkatëse, si dhe me kartelën nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë. Është trajtuar me analgjezikë. Gjatë qëndrimit pacienti nuk ka paraqitur probleme shëndetësore.”

Në përgjigje të kërkesës nga ana jonë drejtuar Komisarariatit të Policisë nr.4, na është vënë në dispozicion kopje e raportit të shërbimit nga libri i planizimit të shërbimit, si dhe janë marrë deklaratat e punonjësve të policisë që kanë shoqëruar shtetasin A.G në Spitalin Universitar të Traumës në datë 13 prill.

Në raportin e shërbimit të datës 13.04.2019 të përpiluar nga punonjësit e policisë të patrullës së përgjithshme, Klevis Mydini dhe Emiljano Vasha rezulton se: *“Ne autopatrulla 53/32 e përbërë nga inspektor Emiliano Vasha dhe inspektor Klevis Mydini të dislokuar me shërbim pikë kontrolli në kryqëzimin e rrugës së Dibrës me rrugën Bardhyl. Në orën 23.40 me urdhër të 52/1 kaluam te Drino ku së bashku me dy agjentët e krimeve Inspektor Aldo Pata dhe Klajdi Xhepaxhiu dhe urgjencën e Tiranës, kaluam në spital ushtarak shtetasin A.G për t’u trajtuar me ndihmë mjekësore. Vlen të theksojmë se ky shtetas sipas informacioneve dhe nga oficeri i rojes, si dhe nga qëndrimi dhe reagimet e tij konstatuam se ishte i dhunshëm dhe agresiv. Duke marrë parasysh qëndrimin e tij dhe reagimet e tij u treguam të kujdesshëm gjatë shoqërimit të tij. Në momentin e mbërritjes te Spitali Ushtarak vumë re se shtetasi filloi të bënte veprime të dyshimta dhe agresive dhe pasi stafi mjekësor na tha se do të kalohej në dhomën numër 5 e cila ishte një dhomë me 5 shtretër të tjerë me pacientë dhe familjarë. Ndaj e vlerësuam të nevojshme të bënim prangosjen e tij në njërën dorë, pasi u konsultuam dhe me stafin mjekësor të cilët na thanë se nuk ndikonte negativisht në shëndetin e tij. Më pas në ambientet e dhomës mjekësore nr.5 u afruan dy ish deputetë të cilët u futën në dhomë, me qëllimin për të krijuar krijuar skena dhe zhurmë, duke bërë titur dhe filmuar. Si rrjedhojë e mosprezantimit të tyre dhe mosidentifikimit të tyre nga ana jonë i kërkua të largoheshin nga i ndaluari. Më pas ata u prezantuan si deputetë dhe ne nuk e pamë të arsyeshme t’i largonim forcërisht nga ambientet e spitalit. Pasi deputetët arritën qëllimin e tyre, u larguan vetë nga ambientet e spitalit. Më pas vumë në dijeni 52/1 për sa ndodhi dhe vazhduam shërbimin në spitalin ushtarak për ruajtjen e tij.”*

Ndërsa në deklaratimet e tyre, punonjësit Klevis Mydini dhe Emiljano Vasha janë shprehur se: *“Në datë 13 prill 2019 rreth orës 23⁴⁰ me urdhër të komandantit kemi shoqëruar me ambulancë shtetasin A.G në Spitalin e Traumës. Personi bëri fillimisht grafinë dhe pastaj kaloi në dhomën nr.5. Gjatë qëndrimit në spital shfaqti agresivitet ndaj nesh, stafit mjekësor dhe personave të tjerë që merrnin shërbim në ambientet e dhomës nr.5. Pasi u munduam ta qetësonim disa herë, ai u bë shumë agresiv duke tentuar të hiqte serum. Edhe vetë infermierja na kërkoi ta qetësonim që të bënte serum. Vlerësuam se ishte një situatë e ndërlikuar dhe për këtë arsye u detyruam ta prangosnim me njërën dorë të koka e krevatit, pasi nuk kishte mënyrë tjetër për ta qetësuar. Ky fakt ndodhi rreth orës 01⁰⁰.*

Gjatë kësaj kohe, kemi qenë vetëm dy persona që e kemi shoqëruar në këto ambiente. Dy agjentët kanë qenë në korridorin e spitalit. Pas marrjes së mjekimit, pas 20 minuta - gjysëm ore u qetësua, i hoqëm prangat dhe kaloi në dhomë tjetër.”

Në përgjigjen nr.1227/1, datë 09.07.2019 të Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave lidhur me hetimin disiplinor të punonjësve të Komisarariatit të Policisë nr.4 për prangosjen e shtetasit A.G, sqarohet se për çdo pretendim për veprimet e punonjësve të policisë, shtetasi mund t'i drejtohet prokurorit të çështjes, i cili në bazë të nenit 24 të Kodit të Procedurës Penale, është autoriteti që drejton dhe kontrollon hetimin, si dhe t'i parashtrorë gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes.

Në përgjigjen nr.1746/1, datë 17.02.2020 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është dërguar informacioni se pas verifikimit të kryer në regjistrin e kallëzimeve penale të vitit 2019 nuk rezultoi që nga ana e shtetasit A.G dhe as nga ndonjë institucion të jetë paraqitur kallëzim penal në lidhje me dhunën e ushtruar ndaj tij nga punonjësit e policisë në protetsën e datës 13 prill 2019.

Nga i gjithë dokumentacioni i administruar konstatohet se shtetasi A.G është kapur nga punonjësit e policisë së Komisarariatit nr.4, punonjës të strukturave të krimeve dhe të veshur civilë, të cilët në pretendimet e tyre kanë referuar se i kanë kërkuar që të ndalonte se ishin të policisë, por ai ka refuzuar duke i sharë dhe ofenduar, si dhe duke bërë rezistencë. Ndërkohë nga vetë shtetasi pretendohet për dhunë të ushtruar nga këta të fundit. Më pas, punonjësit e policisë kanë lajmëruar sallën operative për të dërguar patrullën e shoqërimit. Pasi kanë ardhur forcat me automjetin, është bërë i mundur shoqërimi i tij në komisariatin nr.4. Aty është mbajtur fillimisht i shoqëruar ku është regjistruar në orën 22⁰⁰, më pas kur ai ka paraqitur ankesa shëndetësore, janë marrë masat nga ana e komisarariatit për shoqërimin e tij në Spitalin Universitar të Traumës në orën 23⁴⁰. Sipas raportit të shërbimit të datës 13.04.2019 është prangosur në njërën dorë në krevatin e spitalit, gjatë kohës që merrte trajtimin mjekësor. Sipas procesverbalit të arrestimit në flagrancë figuron se A.G është arrestuar në orën 02⁰⁰ të natës më datë 14.04.2019.

Vlerësojmë se mbajtja e shtetasit A.G, të prangosur në një shtrat spitali, duke qenë në cilësinë e personit të shoqëruar është në kundërshtim të hapur me parashikimet ligjore dhe nënligjore, si dhe konsiderohet shkelje e rëndë e të drejtave të njeriut, trajtim degradues e çnjerëzor sipas Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Si ligji nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, ashtu edhe “Procedurat standarde, rregullat teknike të shoqërimit në polici” miratuar me urdhrin nr.306, datë 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, nuk parashikojnë prangosjen e personave të shoqëruar.

Sipas nenit 17 të Kushtetutës: *“Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në KEDNJ.*

Sipas nenit 28/5 të Kushtetutës: *“Çdo person, të cilit i është hequr liria sipas nenit 27 ka të drejtën e trajtimit njerëzor dhe të respektimit të dinjitetit të tij. Ndërsa në nenin 25 të Kushtetutës është parashikuar se: “Askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues”.*

Në përfundim të hetimit të këtij rasti me iniciativë, Avokati i Popullit, pavarësisht pozitës ligjore në të cilën gjendej shtetasi A.G, shpreh shqetësimin e tij dhe e gjen me vend në këtë rast të ndalet dhe të analizojë këtë sjellje që cenon rëndë të drejtat themelore të individëve sikurse është ai i mbajtjes lidhur me pranga të personave të shoqëruar/ndaluar në kushte spitalore.

Përfundimi i mësipërm gjen pasqyrim edhe në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, e cila në disa vendime të saj ka trajtuar problemin e përdorimit të prangave ndaj të arrestuarve të sëmurë (mund të përmendim çështjet Mouisel kundër Francës, Aplikimi nr.67263/01, datë 14 Nëntor 2002, Henaf kundër Francës Aplikimi nr.65436/01, datë 27 Nëntor 2003, Istratii dhe të tjerët kundër Moldavisë, 27 mars 2007, nr.8721/05, 8705/05 dhe 8742/05).

Për pasojë, në të tilla raste, shteteve të përfshira në këto procese iu janë caktuar detyrime financiare për shkelje të nenit 3 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Madje shpesh nëpërmjet këtyre vendimeve shtetet palë kanë marrë masa për të rishikuar kuadrin ligjor kombëtar, duke caktuar standarde të pranueshme dhe të arsyeshme të sigurisë ndaj personit.

Komiteti i Parandalimit të Torturës (CPT) të Këshillit të Europës është shprehur se praktika e mbajtjes së prangosur në spital të personave të burgosur është një akt degradues ndaj individëve dhe duhet zëvendësuar me masa të tjera alternative sigurie. Në mënyrë të qartë një qëndrim i tillë është mbajtur në Raportin e Dytë të Përgjithshëm të KPT-së (CPT/inf (92)3), ku midis të tjerash citojmë: *“Të burgosurit e dërguar në spital për t’u trajtuar nuk duhet të lidhen fizikisht në shtretërit e tyre të spitalit ose në pajisje të tjera për arsye ruajtje. Mundet dhe duhet të gjenden mjete të tjera që të plotësojnë kënaqshëm nevojat e sigurisë”*. Ky përfundim ka ardhur si rezultat i shumë konstatimeve të këtij Komiteti gjatë vizitave në vendet anëtare të Këshillit të Europës, ku objekt ka qenë trajtimi i personave të kufizuar nga liria.

Po ashtu, bazuar në parashikimet e nenit 94 të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, *“Punonjësi i policisë është i detyruar të respektojë rregullat e sjelljes dhe etikës gjatë përmbushjes së detyrave.”*

Policia e ushtron veprimtarinë e saj ekskluzivisht në bazë dhe në zbatim të ligjit, në interes të personave, të komunitetit, në mbështetje të institucioneve shtetërore, për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe dinjitetit njerëzor, të parashikuara në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, në Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, në Kodin Evropian të Etikës së Policisë, si dhe në akte të tjera ndërkombëtare, në përputhje me parimet e ligjshmërisë, mosdiskriminimit, respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, proporcionalitetit, pavarësisht operacionale, paanshmërisë politike, integritetit, meritës dhe profesionalizmit, transparencës, ruajtjes së informacionit të klasifikuar, kontrollit dhe llogaridhënies.

Policia nuk përdor dhe nuk toleron torturën, trajtimin çnjerëzor apo degradues. Përdorimi i forcës fizike, mjeteve speciale dhe armëve të zjarrit pranohet në mënyrë proporcionale dhe në përputhje të ngushtë me ligjin, vetëm në rast se mënyrat e tjera jo të dhunshme nuk sigurojnë përmbushjen e attributeve të Policisë.

Gjithashtu, Shërbimi i Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave duhet të ushtrojë detyrën me përgjegjshmëri dhe në përputhje me objektin e veprimtarisë së tij për: a) parandalimin, zbulimin dhe hetimin e veprave penale, si dhe të shkeljeve të ligjit, të kryera nga punonjësit e strukturave gjatë ushtrimit të detyrës dhe për shkak të saj; b) inspektimin dhe trajtimin e ankesave ndaj punonjësve të strukturave për mospërbushje të detyrës, sipas standardeve të miratuara me akte normative, për vepra penale dhe shkelje të tjera të ligjit; c) ruajtjen e integritetit të punonjësve të strukturave etj.

Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës, Trajtimit ose Dënimit Çnjerëzor ose Poshtëruës (CPT), ka bërë rekomandime konkrete në raportin tyre për Shqipërinë të botuar gjatë vitit 2019¹, në lidhje me faktin se hetimet nga prokuroria për rastet e dhunës, duhet të hetohen me shpejtësi e efikasitet dhe të ndara nga hetimet për akuzat e ngritura ndaj personit në konflikt me ligjin, ndaj të cilit është ushtuar dhunë.

Në përgjithësi, CPT ka vërejtje për faktin se shqyrtimi i pretendimeve, për keqtrajtim të policisë, i kishte kaluar të njëjtit prokuror, që ishte përgjegjës për hetimin penal kundër personit, i cili pretendohet se është keqtrajtuar.

Punonjësit e policisë në të gjitha nivelet të jenë të vetëdijshëm se qeveria është e vendosur të pengojë keqtrajtimin e personave të privuar nga liria, duke forcuar përgjegjshmërinë e policisë dhe duke hetuar në mënyrë efektive pretendimet për keqtrajtim.

Në pikën 15 të raportit përshkruhet se, përbërës thelbësor i çdo strategjie, për të parandaluar keqtrajtimin është shqyrtimi i kujdesshëm nga autoritetet kompetente, i të gjitha ankesave për keqtrajtim dhe dhënia e një dënimi të përshtatshëm. Nëse, nuk ka reagim të shpejtë dhe efektiv ndaj një të dhëne për keqtrajtim, personat e cenuar shpejt do të besojnë se këto shkelje nuk ndëshkohen. Në mënyrë që hetimi mbi keqtrajtimin e mundshëm të policisë të jetë efektiv, procedura duhet të jetë e pavarur dhe e paanshme. Hetime të tilla, duhet të përputhen ndër të tjera me kriterin e shpejtësisë, tërësisë dhe gjithëpërfshirjes.

Policimi konsiderohet si manifestim i dukshëm i autoritetit shtetëror, ku ndër detyrat më të rëndësishme të saj, është dhe mbrojtja e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Prandaj dhe shërbimet policore, duhet t'i përshtaten parimeve të demokracisë, llogaridhënies dhe respektimit, të të drejtave të njeriut.

Oficerët e policisë gjithashtu, duhet të trajnohen, që të mos përdorin forcë më shumë sesa është nevojshme, kur kapin një person dhe pasi ai është arrestuar dhe mbahet nën kontroll, nuk mund të ketë asnjë justifikim, për goditjen e tij. Kur vlerësohet e nevojshme të prangoset një person, prangat në asnjë rrethanë nuk duhet të jenë tepër të shtrënguara dhe duhet të mbahen, për aq kohë sa është e nevojshme.

Sa i përket procedurave të kryerjes së ekzaminimit mjeko-ligjor në lidhje me rastet e keqtrajtimit të mundshëm të policisë, delegacioni i CPT-së gjatë vizitës monitoruese është informuar se ekzaminimi mjeko-ligjor nga instituti mund të bëhet vetëm nëse kërkohet nga policia, prokurori ose Avokati i Popullit. Personat e ndaluar, të cilët pretendohet se

¹ CPT ka bërë publik në datën 17.09.2019, raportin mbi vizitat që ka kryer në disa institucione të privimit të lirisë në Shqipëri, nga data 20 deri në datën 30 Nëntor 2018. <https://www.coe.int/en/web/cpt/-/council-of-europe-anti-torture-committee-publishes-report-on-alban-3>

janë keqtrajtuar nga policia nuk kishin të drejtë të kërkonin vetë një ekzaminim mjekoligjor, por ata së pari duhet të raportonin në polici ose në prokurori në mënyrë që të regjistrohej një kërkesë zyrtare. CPT thekson se një gjendje e tillë është jo në përputhje me standardet e vendosura ndërkombëtare (paragrafi 123 i "Protokollit të Stambollit").

Për këtë arsye, CPT ka rekomanduar që autoritetet shqiptare të ndërmarrin hapat e nevojshëm për të ndryshuar legjislacionin përkatës.

Në bazë të nenit 24/1 të Kodit të Procedurës Penale, prokurori ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit, drejton dhe kontrollon hetimet paraprake dhe veprimtarinë e policisë gjyqësore, si dhe kryen vetë çdo veprim hetimor që e çmon të nevojshëm, merr masa për ekzekutimin e vendimeve penale, mbikëqyr ekzekutimin e tyre, si dhe ushtron funksionet e bashkëpunimit gjyqësor me autoritetet e huaja, sipas rregullave të caktuara në këtë Kod.

Në rastin objekt hetimi, vlerërojmë se veprimet e punonjësve të policisë për prangosjen e shtetasit A.G, të cilët kryejnë funksionin shtetëror, si punonjës të Policisë së Shtetit, përmbajnë elementet e veprës penale të “kryerjes së veprimeve arbitrare”, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 250 dhe 25 të Kodit Penal.

Për sa më sipër, bazuar në pikën 3, të nenit, 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: “*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike*”; në nenin 21/ pikat c dh ç, të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, në të cilin thuhet se: “*Pas përfundimit të hetimeve, Avokati i Popullit..., i rekomandon prokurorisë të fillojë hetime në qoftë se vëren se është konsumuar figura e një vepre penale, ose të rifillojë hetimet e pushuara ose të pezulluara*”,

REKOMANDOJMË:

Fillimin e hetimeve ndaj punonjësve përgjegjës të policisë të Komisarariatit nr.4 Tiranë, për veprën penale të “Kryerjes së veprimeve arbitrare”, parashikuar nga nenet 250 dhe 25 të Kodit Penal, të ndryshuar për prangosjen e shtetasit A.G gjatë kohës që merrte trajtim mjekësor në Spitalin Universitar të Traumës, në datë 13.04.2019.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, lutemi na njoftoni brenda afatit ligjor prej 30 ditësh, të parashikuar në nenin 22 të ligjit “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Bashkëlidhur ju dërgojmë me cilësinë e provave, kopje të vërtetuara me vulën e institucionit tonë të dokumenteve të mëposhtme:

1. Shpjegimet e shetasit A.G;
2. Shpjegimet e punonjësve të Komisarariatit nr.4 Viktor Gjika, Sabah Fetahu, Ylli Hasani, Ilir Fejza, Ferald Leka, Klevis Mydini dhe Emiljano Vasha;
3. Kartela mjekësore e administruar në Komisariatin nr.1;
4. Kartela mjekësore e administruar në IEVP “Jordan Misja”;

5. Raport shërbimi i datës 13.04.2019;
6. Fotografi të regjistrit të të shoqëruarve, procesverbalit të arrestimit në flagrancë;
7. Fotografi të shtetasit A.G;
8. Shkresat nr.3745/1, datë 07.06.2019 të Komisarariatit nr.4 dhe nr.1227/1, datë 09.07.2019 të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERE

Ermonela RUSPI